



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 441/4 Prot.

Tiranë, më 12.10.2022

V E N D I M

Nr.123, datë 12.10.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë në procedurën së konkurrimit me kod # 3999, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës” dhe për procedurën me kod # 4001, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Zbatimit të Projekteve”, në Drejtorinë e Projekteve, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e konkurrimit me kod # 3999, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës” dhe për procedurën me kod # 4001, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Zbatimit të Projekteve”, në Drejtorinë e Projekteve, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 441 prot., datë 11.05.2022, dërguar nga konkurrentja *****, janë ngritur disa pretendime për parregullsi të kryera/lejuara në

procedurën e konkurrimit me kod # 3999, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës” dhe për procedurën me kod # 4001, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Zbatimit të Projekteve”, në Drejtorinë e Projekteve, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet shkresës nr. 441/1 prot., datë 24.05.2022, “Kërkim dokumentacioni për verifikimin e pretendimeve të konkurrentes *****”, në lidhje me zhvillimin e procedurave për pozicionin e punës me kod # 3999 dhe kod # 4001”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike, ka njoftuar fillimin e verifikimit të ligjshmërisë së këtij rasti, duke kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e këtij hetimi administrativ.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 3343/1 prot., datë 03.06.2022, datë “Kthim përgjigje”, ka vënë në dispozicion gjithë praktikën e kërkuar nga Komisioneri, në lidhje me veprimet administrative të kryera.

Nga përmbajtja e akteve të vëna në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike dhe dokumentacioni që shoqëron kërkesën e paraqitur, rezulton e vërtetuar se konkurrentja ***** ka treguar interes dhe ka marrë pjesë në procedurën e konkurrimit me kod # 3999, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës” dhe për procedurën e konkurrimit me kod # 4001, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Zbatimit të Projekteve, në Drejtorinë e Projekteve, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës” dhe nuk ka rezultuar fituese.

Bazuar në nenin 16, Kreu III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u shqyrtua materiali shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunëses, si dhe dokumentacionin shoqërues të vënë në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar si më poshtë:

Konkurrentja *****, për pretendimet e saj, në lidhje me rezultatin e vlerësimit të dy procedurave në fjalë, për ngritje në detyrë, ka paraqitur ankesë pranë Departamentit të Administratës Publike, duke vënë në dijeni njëherësh, edhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke parashtruar arsyet e mëposhtme:

1. Testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë, për shpalljen me kod # 3999, fillimisht ishte parashikuar të realizohej në datën 20.04.2022 ora 14:00 deri në orën 14:30,

ndërsa për shpalljen me kod # **4001**, testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë, ishte parashikuar të realizohej në datën 21.04.2022 ora 14:00 deri në orën 14:30.

Sipas pretendimeve të konkurrentes, Departamenti i Administratës Publike, i ka komunikuar asaj dhe kandidatëve të tjerë se, në pamundësi për të realizuar procedurat e sipërcituara në datat dhe oraret e paracaktuara, për procedurën e konkurrimit me kod #**3999**, testimi me shkrim do të zhvillohej në datën 27.04.2022, në orën 11:00, ndërsa intervista e strukturuar me gojë, po atë datë në orën 12:00, dhe në vijim, për shpalljen me kod #**4001**, testimi me shkrim do të kryhej në të njëjtën datë, në orën 11:30, ndërsa intervista e strukturuar me gojë në orën orën 13:30.

Për këtë arsye, kandidatja ka paraqitur verbalisht shqetësimin e saj në lidhje me oraret kaq të përafërta për zhvillimin e këtyre procedurave, gjë e cila sipas saj do të ndikonte negativisht në gjendjen emocionale dhe aspektet psikologjike, të cilat vijnë si pasojë e (*rradhës së gjatë të aplikantëve, pritja, stresi, lodhja, temperaturat e larta etj..*) dhe në përfundim mund të ndikojnë në performancën e saj, për gjatë zhvillimit të procedurave të lartpërmendura. Për këtë shqetësim të paraqitur nga ana e saj, kandidatja deklaroi se, nuk pati asnjë reflektim nga ana e strukturave kompetente të Departamentit të Administratës Publike.

2. Në lidhje me shpalljen me kod # **3999**, në vlerësimin e jetëshkrimit, pretendohet që Komiteti i Përhershëm i Pranimit, nuk është treguar i saktë, pasi e ka vlerësuar me 18 pikë nga 20 pikë të mundshme, ndërkohë që sipas saj ajo i tejkalonte kërkesat e shpalljes, në dokumentacionin e ngarkuar në sistem dhe për rrjedhojë anëtarët e KPND, duhet të reflektonin në një rivlerësim më të drejtë për të.

Në kuadër të verifikimit të pretendimeve të mësipërme, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, konstatohet se Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë, është mbledhur fillimisht, për ti marrë në shqyrtim dhe trajtuar ato, në datën 13.05.2022, ora 13:00 (*dokumentuar kjo, në procesverbalin për rastet e veçanta të KPND-së*), por kandidatja nuk është paraqitur për të dhënë shpjegimet e saj dhe për këtë arsye, ky Komitet është rimbledhur në datën 16.05.2022, datë në të cilën ka marrë në shqyrtim të dy ankesat e paraqitura nga kandidatja në fjalë, si për procedurën me kod # **3999**, për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës*” ashtu dhe për procedurën e konkurrimit me kod # **4001**, për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Zbatimit të Projekteve, në Drejtorinë e Projekteve, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës*” kategoria III-a.

Fillimisht është shqyrtuar ankesa për procedurën e ngritjes në detyrë me kod # **3999**, për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit*

Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës” nga ku ka rezultuar si më poshtë vijon:

Së pari, në lidhje me vlerësimin e testimit me shkrim, Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë, ka arritur në përfundimin se kandidati ka merituar 34 pikë, nga 40 të mundshme. Teza e provimit ka qenë e konceptuar me 20 pyetje me alternativa, ku për sejcilën pyetje vetëm njëra nga alternativat ishte përgjigja e saktë. Theksohet këtu se, korrigjimi i testeve nuk realizohet manualisht nga Komiteti, por nga sistemi kompjuterik, i cili gjeneron rezultatin për çdo kandidat.

Në mledhjen e tij, KPND ka riverifikuar materialet e administruara në ditën e testimit si më poshtë vijon:

- Procesverbalin e paraqitjes në testimin me shkrim;
- Tezën e testimit;
- Fletën e përgjigjeve të testimit me shkrim, të kandidatit, të skanuar.

Gjatë riverifikimit të materialeve të mësipërme, nuk është konstatuar ndonjë pasaktësi, shënim apo ndërhyrje në to, që mund të cënojë vlefshmërinë e tyre.

Pas ankesës së paraqitur nga kandidati, KPND ka marrë dhe një herë në shqyrtim tezën e kandidatit dhe bëri verifikimin e përgjigjeve të dhëna në testimin me shkrim, sipas çelësit të përgjigjes për sejcilën pyetje. Në këtë rast, KPND ka konstatuar se, kandidati ka dhënë 17 përgjigje të sakta për të cilat është vlerësuar me 34 pikë dhe 3 përgjigje kanë qenë të gabuara. Pas rivlerësimit të testimit me shkrim, KPND i ka qëndruar të njëjtit vlerësim 34 pikë, nga 40 të mundshme.

Së dyti, në përgjigje të pretendimeve të kandidatës lidhur me intervistën me gojë, KPND ka konstatuar se ajo është vlerësuar me 15.8 pikë nga 40 pikë të mundshme. Meqënëse mbi bazën e kërkesës së konkurrentes, intervista me gojë ishte e regjistruar, është kryer ridëgjimi i saj, por edhe pas kësaj është arritur në të njëjtin përfundim.

Nisur nga sa më sipër, në përfundim KPND kandidaten ***** në lidhje me procedurën e ngritjes në detyrë me kod # **3999**, për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës*”, e ka vlerësuar me 67.8 pikë, nga 100 pikë të mundshme.

Në vijim, Komitetit të Pranimit për Ngritje në Detyrë, ka shqyrtuar dhe ankesën e paraqitur nga kandidata për procedurën e ngritjes në detyrë me kod # **4001**, për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Zbatimit të Projekteve, në Drejtorinë e Projekteve, në Agjencinë*”,

kategoria III-a, nga ku ka rezultuar se, kandidatja *****, ka marrë pjesë vetëm në testimin me shkrim dhe për këtë arsye është vlerësuar vetëm për këtë testim.

Në këtë rast, Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë, në lidhje me vlerësimin e testimin me shkrim, ka konstatuar se kandidati është vlerësuar me 34 nga 40 pikë të mundshme. Edhe kjo tezë e provimit është konceptuar me 20 pyetje me alternativa, ku për sejcilën pyetje vetëm njëra nga alternativat është përgjigja e saktë. Korrigjimi i testeve edhe në këtë rast nuk është realizuar manualisht nga KPND, por nga sistemi kompjuterik, i cili gjeneron automatikisht, rezultatin për çdo kandidat.

Pas verifikimit të materialeve të testimin me shkrim të kësaj procedure, nuk është konstatuar ndonjë pasaktësi, shënim apo ndërhyrje në to, që mund të cënonte vlefshmërinë e tyre. Pas rivlerësimit është konstatuar se, konkurenti ka dhënë 17 përgjigje të sakta, për të cilat është vlerësuar me 34 pikë dhe 3 përgjigje kanë qenë të gabuara.

Pas rivlerësimit të testimin me shkrim, KPND i ka qëndruar të njëjtit vlerësim, 34 pikë nga 40 të mundshme.

Gjithashtu, Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND) ka sqaruar se shkak i shtyrjes së datës së konkurrimit, nga data 21.04.2022, në datën 27.04.2022, ka qenë për arsye objektive, pasi dy prej anëtarëve të KPND-së përfaqësues të institucionit, nuk kishin mundësi të paraqiteshin në datën 21.04.2022, në të cilën ishte parashikuar fillimisht zhvillimi i procedurës, prandaj ajo është shtyrë dhe zhvilluar në datën 27.04.2022.

Për këto arsye:

Në zbatim të nenit nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” dhe në nenin 16, pika 6, të Kreut III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të informacionit të regjistruar me nr. 441 prot., datë 11.05.2022, me objekt verifikimin e pretendimeve për parregullsi të kryera apo të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit me kod # 3999, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve, në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës” dhe të procedurës me kod #4001, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Zbatimit të Projekteve”, në Drejtorinë e Projekteve, në Agjencinë Shtetërore të

Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës dhe meqënëse nuk u gjetën parregullsi në zhvillimin e tyre, të vendoset arkivimi i çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim, njësia përgjegjëse (*DAP*).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha